



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
E UNIVERSITETIT ‘ISMAIL QEMALI’ VLORE

PËR IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJEVE NDËR-INSTITUCIONALE
NË KUADËR TË PROGRAMIT
ERASMUS + KA1 INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY

miratuar me Vendim Nr. , dt. -05-2025 të Senatit Akademik të UV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

HYRJE

Erasmus+ është program i BE-së, i cili nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës, mbështet zhvillimin arsimor, profesional dhe personal të njerëzve në arsim, trajnim, rini dhe sport në Evropë dhe më gjerë.

Erasmus+ kontribuon në rritjen e qëndrueshme, punë cilësore, nxitjen e inovacionit dhe forcimin e identitetit evropian dhe qytetarisë aktive duke ofruar një përvojë mësimore që ndryshon jetën për miliona qytetarë të BE-së dhe mbështet aktivitete të ndryshme si lëvizshmëria e të mësuarit, bashkëpunimi dhe reforma e politikave.

Për tu bërë pjesë e programit duhet që të nënshkruhet një marrëveshje ndërinstitucionale, e cila është një dokument tip (Shtojca 1) që lidhet ndërmjet dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, ku minimumi një prej palëve duhet të jetë pjesë e arsimit të zonës Evropiane (vendi i programit) dhe që bien dakord të bashkëpunojnë për shkëmbimin e studentëve dhe personelit.

Nënshkrimi i marrëveshjes ndërinstitucionale angazhon palët të respektojnë parimet dhe kërkesat e cilësisë së Kartës Erasmus për Arsimin e Lartë (ECHE) në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e mobiliteteve.

Kjo rregullore hartohet për t'i ardhur në ndihmë të gjithë studentëve, personelit dhe strukturave të përfshira në ndërkombëtarizimin e Universitetit ‘Ismael Qemali’ Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është zbatimi në një mënyrë të drejtë, transparente dhe të dokumentuar i marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+KA1.

Gjithashtu, kjo rregullore synon të mbështesë zhvillimin njerëzor, institucional, arsimin cilësor dhe modernizimin e Universitetit 'Ismael Qemali' Vlorë (UV), duke rritur vizibilitetin e tij në nivel lokal dhe global.

Neni 2
Baza ligjore

Hartimi i kësaj rregulloreje është në përputhje me :

- Guida e Programit Erasmus+.
- Manuali i Erasmus+ mbi Lëvizshmërinë Ndërkombëtare të Kredive "*Erasmus+ International Credit Mobility Handbook*".
- Manuali standard ndërkombëtar i klasifikimit të hollësishëm i fushave të arsimit dhe trajnimit 2013 "*International Standard Classification of Education, Fields of education and training 2013 (ISCED-F 2013) – Detailed field descriptions*"
- Ligji nr.80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*",
- Statuti i Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.
- Rregullore e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.
- VKM nr. 781 e datës 26.12.2018 "*Për garantimin e transparencës në IAL-të Publike*".

Neni 3
Marrëveshja ndërinstitucionale dhe negocimi i saj

1. Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë nënshkruan një marrëveshje ndërinstitucionale, e cila është një dokument tip sipas shtojcës në këtë rregullore, që lidhet ndërmjet dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, ku minimumi një prej palëve duhet të jetë pjesë e arsimit të zonës Evropiane (vendi i programit) dhe që bien dakord të bashkëpunojnë për shkëmbimin e studentëve dhe personelit.
2. Rektori është autoriteti i vetëm, që nënshkruan një marrëveshje ndërinstitucionale dhe dokumente të tjera shtesë mbi angazhimin dhe përfshirjen në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë partnere ndërkombëtare.

a) NIPT: K56703246N



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- b) OID: E10159336
c) PIC: 934361522
d) ECHE: ALVLORE01
3. Të drejtën për të negociuar lidhjen e një marrëveshje ndërinstitucionale e ka Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë (SMJ) dhe personeli akademik, të cilët ndjekin procedurat sipas rasteve si vijon:
- a) Procedura e negocimit të marrëveshjes ndërinstitucionale nga SMJ:
- Në rastin kur marrëveshja lidhet për herë të parë, SMJ mbledh informacionin e nevojshëm nga institucioni partner dhe identifikon fushat e përbashkëta sipas manualit ISCED. SMJ u kërkon departamenteve sipas rastit të shprehin interesin për përfshirjen apo mos përfshirjen e tyre në bashkëpunim.
 - Pas konfirmimit prej departamenteve, SMJ përpilon draft marrëveshjen ndërinstitucionale, e cila i dërgohet për konfirmim Sektorit Juridik e më pas e përcjell te Rektori për nënshkrim duke propozuar drejtuesin e njësisë bazë ose një person tjetër të rekomanduar nga ky i fundit, si koordinatori e marrëveshjes sipas fushave korresponduese ISCED.
- b) Procedura e negocimit të marrëveshjes ndërinstitucionale nga personeli akademik:
- Personeli akademik duhet që paraprakisht të konfirmojë me SMJ-në nëse UV ka një partneritet me institucionin e huaj që kërkon të lidhë marrëveshjen.
 - Në rastin kur marrëveshja lidhet për herë të parë, personeli akademik përcjell te drejtuesi i njësisë bazë kërkesën për nënshkrimin e marrëveshjes prej Rektorit dhe për tu miratuar si koordinator marrëveshje ai ose një personel i sugjeruar prej tij.
 - Drejtuesi i njësisë e përcjell kërkesën për nënshkrimin e marrëveshjes dhe për miratimin e koordinatorit te Dekani, i cili ky i fundit e dërgon pranë Rektorit të UV-së.
 - Pas nënshkrimit të marrëveshjes, komunikimi dhe kontakti me institucionin partner mbahet me prioritet nga koordinatori i projektit, i cili në çdo rast vendos në komunikimin elektronik edhe SMJ (cc).
4. Në rastin kur marrëveshja ndërinstitucionale rinovohet, SMJ përcjell për sugjerime draftin paraprak të azhurnuar te drejtuesi i njësisë bazë dhe koordinatori përkatës, ku dhe më pas e dorëzon për konfirmim tek Sektori Juridik e më pas e përcjell te Rektori për nënshkrim.
5. Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërinstitucionale prej Rektorit, ajo përcillet tek institucioni partner nga koordinatori ose prej SMJ-së.
6. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, institucionet angazhohen të respektojnë parimet dhe kërkesat e cilësisë së Kartës Erasmus për Arsimin e Lartë (ECHE) në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e mobiliteteve.
7. SMJ do të ndjek të gjithë hapat nga regjistrimi i marrëveshjes në protokollin e institucionit deri në implementimin dhe përfundimin e periudhës së vlefshmërisë së saj.
8. Informacioni që lidhet me marrëveshjet ndërinstitucionale duhet të publikohet në faqen zyrtare të UV-së (www.univlora.edu.al) te kategoria/ ndërfaqja e Ndërkombëtarizimit.

Neni 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Informacion i nevojshëm për fillimin e zbatimit të marrëveshjes

1. Institucioni partner njofton UV-në mbi rezultatin e aplikimit duke i përcjellë informacionet e nevojshme për zbatimin e marrëveshjes ndërinstitucionale si më poshtë:
 - a) Numrin e bursave për studentët dhe personelin hyrës dhe dalës për secilën palë.
 - b) Llojin e mobilitetit, nëse është studim, praktikë mësimore, mësimdhënie apo trajnim.
 - c) Fushën e studimit sipas kodeve ISCED
 - d) Ciklin e studimeve.
 - e) Periudhën e mobilitetit për studentët dhe personelin.
 - f) Shumën e mbështetjes financiare për dietën ditore/mujore dhe shpenzimet e transportit.
 - g) Afatin e pranimi të aplikimeve.
 - h) Informacione të tjera që lidhen me procedurën e përzgjedhjes, dokumentat që kërkohen për aplikim, etj.
 - i) Shuma e rënë dakord për mbështetje organizative etj.
2. UV vetëm pasi ka marrë informacionin e nevojshëm nga institucioni partner planifikon periudhën dhe përgatit njoftimin/thirrjen për aplikim, i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale të UV-së.
3. I gjithë dokumentacioni nga shpallja e aplikimit për bursa Erasmus+KA1 deri në finalizimin e mobilitetit prej përfituesve ruhet nga SMJ.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

KREU II
PROCEDURA E MOBILITETIT PËR STUDENTËT DALËS TË UV-SË

Neni 5
Të drejtat e studentëve

1. Studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë kanë të drejtën të informohet për mundësitë që ofron programi Erasmus+KA1 për mobilitete përmes kanaleve të komunikimit të universitetit si faqja zyrtare, rrjetet sociale, departamentit, SMJ-së etj.
2. Studentët që përfitojnë nga programi Erasmus+KA ICM gëzojnë status të veçantë përsa i përket detyrimeve akademike në UV sipas përcaktimeve të Rregullores së UV-së.
3. Në rastet kur ka mospërputhje të periudhave të fillimit të mobilitetit në institucionin pritës me sezonin e provimeve semestrale në UV, për provime të mbetura të studentëve fitues të mobilitetit, njësia bazë kujdeset që këto provime të planifikohen në sezonin e radhës më të afërt apo të çelet një sezon i posaçëm që lejon hyrjen e tyre në këto provime.
4. Numri minimal i krediteve që studenti mund të marrë në programin lëndor duhet të jetë në përputhje me detyrimet sipas statutit dhe rregullores së UV-së.
5. Në rast se studenti ndjek komponentë të tjerë lëndorë jashtë atyre që kërkohen në programin e studimit në UV, ato duhet të shtohen në tabelën A të marrëveshjes lëndore.

Neni 6
Kriteret e pranimit

1. Vetëm studentët të cilët studiojnë në UV mund të përfitojnë një bursë në kuadër të programit Erasmus+KA1.
2. Studentët e UV-së mund të kryejë mobilitet disa herë deri në një maksimum prej 12 muajsh për cikël studimi.
3. Studentët e UV-së mund të aplikojnë në mobilitet për studime ose mobilitet për praktikë, nëse janë në ciklin e parë (Bachelor ose ekuivalent), në ciklin e dytë (Master ose ekuivalent), si dhe kandidatë për doktoraturë të ciklit të tretë. Periudha e mobilitetit për dy ciklet e para mund të zgjasë nga 60 ditë deri në 12 muaj, ndërsa për mobilitetet afatshkurtër të doktoraturës ose mobilitetet e kombinuara mund të zgjasë nga 5 deri në 30 ditë.
4. Prioritet do t'u jepet studentëve që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1 ICM.
5. Studentët, të cilët u përkasin grupeve me diversitete sociale, ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të vecanta, nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike ose bursë nga shteti etj., do të kenë përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes për përfitimin e bursës të ofruar nga programi Erasmus+KA1 ICM.
6. Njohja e gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndërinstitucionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

7. Përfshihen studentët, të cilët kanë të raportuar shfaqje të sjelljeve të pahijshme dhe në kundërshtim me rregulloren e UV-së gjatë procesit të aplikimit apo gjatë realizimit të mobilitetit.

Neni 7

Shpallja e thirrjes për aplikim

1. SMJ harton thirrjen për aplikim mobilitete studenti sipas shtojcës 2, duke iu referuar modaliteteve të përcaktuara dhe dërguara nga zyrat ndërkombëtare të institucionit partner ose koordinatorit të marrëveshjes.
2. Thirrja përmban këto elemente:
 - Emrin e projektit të mobilitetit
 - Fushën sipas kodeve ISCED
 - Institucionin pritës
 - Periudhën kohore të mobilitetit
 - Kriteret bazë dhe preferenciale të mobilitetit, të hartuara nga institucioni partner ose koordinatori i marrëveshjes.
 - Afatin kohor të aplikimit
3. Draft thirrja i përcillet elektronikisht me e-mail për mendim drejtuesit të njësisë bazë dhe koordinatorit të marrëveshjes për të konfirmuar draftin brenda 2 ditëve të punës pas marrjes së njoftimit.
4. Drejtuesi i njësisë bazë ngre një komision *ad-hoc* për Ekuivalentimin e Moduleve të mundshme për tu ndjekur nga studentët Erasmus+. Ky komision përcakton modulet e programit mësimor të Universitetit partner, që janë të ekuivalentueshme me modulet e programit mësimor përkatës të UV. Komisioni liston emërtimet e moduleve dhe kreditet që do të njihen në UV për çdo modul të ndjekur në Universitetin partner.

Vendimi i këtij komisioni i dërgohet për zbatim Koordinatorit të programit prej Drejtuesit të Njësisë Bazë. Nëse mobiliteti Erasmus+ është në institucione dhe programe ku ka patur mobilitete të mëparshme (dhe nuk ka ndryshim programesh mësimore) mbetet në fuqi vendimi i Komisionit të mëparshëm.
5. SMJ dërgon elektronikisht me e-mail për publikim thirrjen përfundimtare të struktura përkatëse.
6. Thirrja shpërndahet në kanalet e komunikimit të UV-së si vijon:
 - a) Faqen zyrtare të internetit.
 - b) Rrjetet sociale.
 - c) Postës elektronike (e-mail), sipas rastit.
 - d) Afishime të thirrjes në mjediset pranë departamenteve përkatëse.
 - e) Njoftime pranë auditorëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 8

Dokumentet e aplikimit

1. SMJ është struktura përgjegjëse për pranimin e dokumentacionit të plotë gjatë fashës kohore sipas përcaktimeve të shpallura në thirrjen për aplikim.
2. Dokumentet e detyrueshme për aplikim janë :
 - a) Formular aplikimi sipas shtojcës 3.
 - b) Kopje të letërnjoftimit ID ose pasaportë.
 - c) Lista e notave.
 - d) Vërtetim i njohjes së gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndërinstytucionale. Përjashtim nga ky detyrim bëjnë studentët e programit të gjuhës angleze.
 - e) Letër motivimi në gjuhën angleze.
 - f) Dokument në rastet kur studenti është me aftësi të kufizuara, probleme shëndetësore, barriera që lidhen me sistemet e arsimit dhe trajnimit, dallime kulturore, barrierat sociale, barriera ekonomike, barriera që lidhen me diskriminimin, barrierat gjeografike etj.
 - g) Dokument që liston lëndët, që studenti propozon të marrë në institucionin partner për periudhën e mobilitetit, të mbështetur në katalogun e kurseve të ofruara në gjuhë të huaj në institucionin partner, e cila përpilohet nga Koordinatori Erasmus pas vendimit të komisionit Ad-Hoc dhe miratohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë.
3. Dorëzimi i dokumentave të aplikimit kryhet dorazi pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë.

Neni 9

Komisioni Ad-Hoc i vlerësimit të aplikimeve

1. Në përfundim të afatit të aplikimit të vendosur në thirrje ngrihet prej Rektorit një komision ad-hoc, i cili do të bëjë vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar prej aplikantëve dhe do të rendisë kandidatët në bazë të skemës së pikëzimit si dhe kriterëve të thirrjes.
2. SMJ u komunikon drejtuesve të departamenteve fushat e aplikimeve të mbërritura për të vazhduar me hapat e mëtejshëm për ngritjen e komisionit ad-hoc sipas rasteve si vijon:
 - a) Në rastet kur thirrja i adresohet vetëm studentëve të UV-së që i përkasin një fushe studimi referuar në kodet ISCED të marrëveshjes ndërinstytucionale, Rektori ngre komisionin ad-hoc me përbërje si më poshtë:
 - i. 3 (tre) anëtarë, staf akademik me kohë të plotë, të njësisë bazë që mbulon këtë fushë studimi, të propozuar nga Drejtuesi i njësisë kryesore.
 - ii. 1(një) anëtar nga SMJ.
 - iii. 1(një) student nga i njëjti departament, i propozuar nga Kryetari i Këshillit Studentor të Fakultetit Përkates
 - b) Në rastet kur thirrja i adresohet studentëve të UV-së që i përkasin dy a më tepër fushave të studimit, referuar në kodet ISCED të marrëveshjes ndërinstytucionale, Rektori ngre komisionin ad-hoc me përbërje si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- i. 3(tre) anëtarë, staf akademik me kohë të plotë, të njësive bazë që mbulojnë këto fusha studimi, të propozuar nga Drejtuesi i njësive kryesore. Në rast se fushat e studimit u përkasin disa njësive kryesore, propozimet bëhen nga Rektori.
 - ii. 1(një) anëtar nga SMJ.
 - iii. 1(një) student nga të njëjtat departamente, i propozuar nga Kryetari i Këshillit Studentor.
3. Anëtarët e komisioni ad-hoc njoftohen prej *Sektorit të BNJ dhe Arkiv-Protokollit* të UV-së mbi urdhërin e Rektorit dhe ndërkohë kryetari i komisionit ad-hoc pas marrjes së njoftimit thërret mbledhjen e anëtarëve brenda 5 (pesë) ditëve të punës për të përfunduar procesin e vlerësimit dhe renditjen e kandidatëve aplikues.
 4. Komisioni ad-hoc vlerëson dhe rendit kandidatët duke aplikuar skemën e pikëzimit sipas shtojcës 4, si dhe përpilon vendimin sipas shtojcës 5.
 5. Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, komisioni ad-hoc do t'u japë prioritet:
 - a) Studentëve, të cilët janë me aftësi të kufizuara, probleme shëndetësore, barriera që lidhen me sistemet e arsimit dhe trajnimit, dallime kulturore, barrierat sociale, barrierat ekonomike, barrierat që lidhen me diskriminimin, barrierat gjeografike etj.
 - b) Studentëve që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1 ICM.
 - c) Barazia gjinore (aty ku është e mundur, të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).
 6. Kryetari i komisionit ad-hoc i përcjell vendimin e protokolluar SMJ-së, që kjo e fundit ta dërgojë me postë elektronike (e-mail) tek të gjithë studentët aplikantë.
 7. Proçesi i brendshëm i nominimit nuk garanton që mobiliteti do të kryhet. Nominimi duhet të konfirmohet nga institucioni partner përmes një letre pranimi ose një konfirmimi elektronik nëpërmjet emailit.

Neni 10

Komisioni Ad-Hoc i apelimit

1. Studentët aplikues kanë të drejtën e ankimit të vendimit të komisionit *ad-hoc* pranë Rektorit brenda 3 (tre) ditëve të punës nga marrja e njoftimit.
2. Në rastin kur aplikantët kanë ankimuar vendimin ad-hoc, Rektori ngre një komision apelimi me përbërje si më poshtë :
 - i. 3 (tre) anëtarë të njësive bazë që mbulon këtë fushë studimi, të propozuar nga Drejtuesi i njësive kryesore.
 - ii. 1(një) anëtar nga SMJ.
 - iii. 1(një) student nga i njëjti departament, i propozuar nga Kryetari i Këshillit Studentor.
3. Anëtarët e komisioni të apelimit njoftohen prej *Sektorit të BNJ dhe Arkiv-Protokollit* të UV-së mbi urdhërin e Rektorit dhe ndërkohë, kryetari i komisionit të apelimit pas marrjes së njoftimit thërret mbledhjen e anëtarëve brenda 3 (tre) ditëve të punës për të përfunduar procesin e shqyrtimit të ankesës.
4. Vendimi i komisionit të apelimit është përfundimtar dhe i pa ankimueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

5. Kryetari i komisionit të apelimit i përcjell vendimin e protokolluar SMJ-së, që kjo e fundit ta dërgojë me postë elektronike (e-mail) tek ankimuesit.

Neni 11

Njoftimi i listës së studentëve të nominuar

1. Në përfundim të afatit të ankimimit, SMJ njofton institucionin partner, studentët e nominuar, drejtuesit e departamenteve dhe koordinatoren e marrëveshjes dhe kryesekretaren mbi vendimin ad-hoc për studentët e UV-së.
2. SMJ i vendos në dispozicion institucionit partner kopje të vendimit ad-hoc dhe/ ose çdo dokument tjetër sipas rastit.
3. Institucioni partner konfirmon pranimin e kandidatëve nëpërmjet e-mailit ose formave të ngjashme.

Neni 12

Mbështetja e studentëve të nominuar dhe marrëveshja lëndore

1. Studenti i UV-së udhëzohet dhe mbështetet përpara fillimit të mobilitetit si për çështjet akademike ashtu dhe ato administrative.
2. Drejtuesi i njësisë bazë dhe koordinatori i marrëveshjes, së bashku me studentin, përcaktojnë planin e studimit individual të studentit, gjatë mobilitetit dhe pas tij. Në këtë plan studimi individual paracaktohen modulet (kurset) me kreditet përkatëse, që studenti do të ndjekë gjatë semestrit të mobilitetit në institucionin partner, si dhe modulet dhe kreditet me të cilat ato do të ekuivalentohen në programet UV, sipas listës së miratuar paraprakisht nga Komisioni i Ekuivalentimit të Moduleve (neni 7, pika 3).
Pjesë e planit individual të studimeve është gjithashtu plani i zëvendësimit në semestrat pasardhës në UV të moduleve që nuk arrihen të frekuentohen apo të vlerësohen si *kalues* gjatë semestrit të mobilitetit.
3. Pas përcaktimit të planit individual të studimeve, nga studenti, drejtuesi i njësisë bazë dhe Rektori UV-së, si dhe përfaqësuesit e institucionit partner nënshkruhet një marrëveshje lëndore sipas shtojcës 6 apo formateve, që universitetet partnere aplikojnë në sistemet e tyre.
4. Të gjitha palët që nënshkruajnë marrëveshjen lëndore angazhohen të sigurojnë që studentit ti njihen modulet e ndjekura dhe kreditet e fituara gjatë mobilitetit, sipas Learning Agreement të firmosur në momentin e aplikimit.
5. Pas firmosjes nga palët përfaqësuese të UV-së, marrëveshja lëndore i përcillet SMJ-së për tu dërguar pranë institucionit partner.
6. Në rast se për arsye të ndryshme të jashtëzakonshme, studenti nuk mund të marrë një ose disa komponentë të programit lëndor të propozuar, bëhen ndryshime në programin lëndor të propozuar në pjesën 'Gjatë mobilitetit' të marrëveshjes duke theksuar edhe arsyen e ndryshimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Pas ndryshimeve të propozuara dhe të miratuara nga palët, marrëveshja firmoset në të njëjtën mënyrë si përpara mobilitetit.

7. SMJ mbështet studentin me procedurat për përgatitjen për mobilitet duke i dhënë informacion dhe ndihmën e nevojshme për mënyrën e aplikimit, për lejeqendrimin, për institucionin partner ku do të dërgohet, qytetin, akomodimin etj.

Neni 13

Njohja e periudhës së studimit

1. Në përfundim të periudhës së mobilitetit, institucioni partner është i detyruar të pajisë studentin e UV-së me listën e notave sipas formateve që aplikojnë në sistemet e tij.
2. Për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja ndër-institucionale dhe marrëveshja lëndore, SMJ i përcjell drejtuesit të njësisë bazë ku studenti kryen studimet, të gjithë dokumentacionin e krijuar gjatë implementimit të mobilitetit të studentit, për të kryer njohjen e periudhës së mobilitetit dhe të krediteve të fituara.
3. Drejtuesi i njësisë bazë ngre një komision *ad-hoc* për shqyrtimin e dokumentacionit të dërguar prej SMJ mbi Njohjen dhe Njehsimin e Periudhës së Studimit gjatë Mobilitetit, duke respektuar legjislacionin në fuqi. Ky Komision vlerëson dokumentacionin e arritjeve akademike të studentit në modulet e ndjekura në Universitetin partner gjatë semestrit të mobilitetit dhe plotëson shtojcën 7 në bazë të këtij dokumentacioni, për modulet e ekuivalentuara paraprakisht nga Komisioni i Ekuivalentimit të Moduleve (neni 7, pika 3).
4. Vendimi me shtojcën 7: Dokumenti i Njohjes dhe Njehsimit të Periudhës së Studimit gjatë Mobilitetit duhet të përcillet i plotësuar prej Drejtuesit të Departamentit pranë sekretarisë mësimore përkatëse për ta pasqyruar në regjistrin e rekordeve akademike, si dhe pranë SMJ-së për t'iu dërguar më tej insticionit partner.

Neni 14

Detyrimet e studentëve dalës të UV-së

1. Çdo student është i detyruar të plotësojë pyetësorin "*Participant Report Form*" nga Komisioni Evropian, i cili përmban pyetje për mobilitetin dhe rezultatet e arritura përmes tij.
2. Nëse studenti, gjatë mobilitetit, nuk ka frekuentuar në universitetin partner lëndë të cilat janë dakordësuar në marrëveshjen lëndore, këto duhet të frekuentohen tërësisht në programet akademike të UV-së.
Vlerësimet e moduleve të frekuentuara gjatë semestrit të mobilitetit, hidhen në UVMS nga Sekretaria Mësimore dhe modulet e vlerësuara *jo-kaluese* në testimin përfundimtar në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

institucionin pritës mund të rritet në sezonet e Riprovimeve, sipas rregullave të UV për të gjitha vlerësimet *jo-kaluese*.

KREU III
PROCEDURA E MOBILITETIT PËR STUDENTËT HYRËS NË UV

Neni 15

Njoftimi prej institucionit partner

1. Procedura përzgjedhëse për studentët që vijnë me mobilitet në UV kryhet nga institucioni partner.
2. Institucioni partner dërgon emrat e studentit/ëve të nominuar pranë SMJ-së me të gjithë informacionin shoqërues të detajuar.

Neni 16

Të drejtat e studentit hyrës

Studentët hyrës gëzojnë të drejtën të mbështeten me çdo informacion apo dokument që kërkohet për mbarëvajtjen e mobiliteti të tyre.

Neni 17

Mbështetja e studentëve hyrës dhe marrëveshja lëndore

1. SMJ kontakton me anë të e-mailit studentin/ët e nominuar duke i lidhur me drejtuesin e njësisë bazë dhe koordinatoren e marrëveshjes, si dhe duke vendosur në dispozicion informacionin administrativ mbi hapat që duhen ndjekur para mbërritjes në UV.
2. Studentit i përgatitet një letër pranimi sipas shtojcës 8, si dhe mbështetet me procedurat e posacme për mobilitet duke i dhënë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për mënyrën e aplikimit të lejeqendrimit, akomodimin, lehtësira të tjera sipas kërkesave të parashtruara.
3. Drejtuesi i njësisë bazë dhe koordinatori i marrëveshjes mbështetin studentin me çdo çështje akademike deri në finalizimin e marrëveshjes lëndore.
4. Palët e përfshira në mobilitet sipas rastit (studenti hyrës, drejtuesi i njësisë bazë, koordinatori marrëveshjes dhe Rektori) nënshkruajnë marrëveshjen e mobilitetit.

Neni 18

Regjistrimi në UV

1. Studenti hyrës me ardhjen në UV duhet të paraqitet pranë SMJ-së për të kryer dhe marrë udhëzimet e nevojshme mbi procedurat administrative gjatë mobiliteti pranë UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Studenti hyrës duhet të regjistrohet në sistemin UVMS për të përfutur dhe marrë të gjithë informacionin njësoj si studentët e UV-së nga platforma digjitale.

Neni 19

Njohja e periudhës së studimit për studentë hyrës

1. Në përfundim të periudhës së mobilitetit UV është e detyruar të pajisë studentin hyrës me listën e notave sipas shtojcës 9 ose formatit që aplikon në sistemin e saj, si dhe me çdo dokument shtesë të kërkuar në mbështetje të njohjes së periudhës së mobilitetit.
2. SMJ i përcjell Institucionit partner dhe studentit listën e notave dhe çdo dokument shtesë të kërkuar në mbështetje të njohjes së mobilitetit.

KREU IV

PROCEDURA PËR MOBILITET STAFI DALËS I UV-SË

Neni 20

E drejta për informim

1. Personeli i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë ka të drejtën të informohet për mundësitë që ofron programi Erasmus+KA1 për mobilitete përmes kanaleve të komunikimit të universitetit si faqja zyrtare, rrjetet sociale, njësisë bazë, adresës zyrtare të postës elektronike të Uv-së: international@univlora.edu.al në adresat e postës elektronike individuale të njohura nga UV-ja.
2. Personeli i UV-së gëzon të drejtën të mbështetet me çdo informacion apo dokument që kërkohet për mbarëvajtjen e mobiliteti të tyre.

Neni 21

Kriteret e pranimit

1. Vetëm personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i cili është i punësuar me kohë të plotë në UV, mund të përfutojë një bursë në kuadër të programit Erasmus+KA1 ICM.
2. Personeli i UV-së ka të drejtën të përzgjidhet të kryej mobilitet në kuadër të programit Erasmus+KA171 nëpërmjet tre mënyrave:
 - a) Me thirrje të shpallur nga SMJ, ku personeli hyn në konkurrim dhe ka të drejtën e përzgjedhjes pas vlerësimit të komisionit *Ad-Hoc*.
 - b) Me nominim nga universiteti partner, nëpërmjet ftesës shkresore ose postës elektronike.
 - c) Me nominim nga Rektori, kur afatet kohore janë të pamjaftueshme për të shpallur thirrjen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

3. Personeli i UV-së mund të aplikojë për një periudhë mobiliteti nga 5 ditë deri në 2 muaj sipas llojit të mëposhtëm:
 - a) Mobilitet për mësimdhënie, i cili është i vlefshëm për personelin akademik. Këto mobilitete mund të jenë në çdo fushë/ disiplinë akademike sipas kodeve ISCED në përputhje me fushat /disiplinat akademike të institucionit partner. Personeli akademik, gjatë periudhës së mobilitetit duhet të respektojë planin e mësimdhënës me një minimum prej 8 orë mësimdhënie/në javë. Nëse mobiliteti është i kombinuar dhe me trajnim, duhet të respektohet një minimum prej 4 orë mësimdhënie në javë.
 - b) Mobilitet për trajnim, i cili është i vlefshëm për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto mobilitete zhvillohen në formën e aktiviteve trajnuese.
4. Prioritet do t'u jepet aplikantëve që nuk kanë përfutur më parë nga programi Erasmus+ KA1 ICM ose që kanë përfutur më pak, sipas Database të *Mobiliteteve të Stafit të UV* në SMJ dhe website e UV.
5. Personeli, të cilët janë me aftësi të kufizuara, probleme shëndetësore, barriera që lidhen me sistemet e arsimit dhe trajnimit, dallime kulturore, barrierat sociale, barriera ekonomike, barriera që lidhen me diskriminimin, barrierat gjeografike etj, do të kenë përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes për përfutimin e bursës së ofruar nga programi Erasmus+KA1.

Neni 22

Shpallja e thirrjes për aplikim

1. SMJ harton thirrjen për aplikim sipas shtojcës 10 për mobilitete personeli sipas modaliteteve të përcaktuara dhe dërguara nga zyrat ndërkombëtare të institucionit partner ose koordinitorit të marrëveshjes.
2. Thirrja përmban këto elemente:
 - Emrin e projektit të mobilitetit
 - Fushën e studimit sipas kodeve ISCED
 - Institucionin pritës
 - Periudhën kohore të mobilitetit
 - Kriteret bazë dhe preferenciale të mobilitetit, të hartuara nga institucioni partner ose koordinatori i marrëveshjes.
 - Afatin kohor të aplikimit
3. Draft thirrja i përcillet me e-mail për mendim drejtuesit të njësisë bazë dhe koordinitorit të marrëveshjes për të konfirmuar draftin brenda 2 ditëve të punës pas marrjes së njoftimit.
4. SMJ përcjell në formë shkresore dhe me e-mail thirrjen përfundimtare për publikim te struktura përkatëse.
5. Thirrja shpërndahet në kanalet e komunikimit të UV-së si vijon:
 - a) Faqen zyrtare të internetit.
 - b) Rrjetet sociale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

c) Postës elektronike (e-mail) sipas rastit.

Neni 23

Dokumentet e aplikimit

1. Dokumentet e detyrueshme për aplikim janë:
 - a) Formular aplikimi sipas shtojcës 11.
 - b) Kopje të letërnjoftimit ID ose pasaportë.
 - c) Dokument që vërteton statusin e të punësuarit pranë UV-së.
 - d) Jetëshkrimi (Curriculum Vitae) në gjuhën angleze.
 - e) Vërtetim nga Rektori (për stafin jo-akademik), Administratori (për stafin administrativ) dhe Dekani (për stafin akademik në varësi), që miraton Lejen për Aplikimin në Mobilitet.
 - f) Vërtetim i njohjes së gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndërinstitucionale. Përjashtim nga ky detyrim bëjnë personeli i programeve të gjuhës angleze dhe personeli që ka një diplomë universitare të një programi të zhvilluar në gjuhën angleze.
 - g) Letër motivimi në gjuhën angleze.
 - h) Dokument në rastet kur personeli është me aftësi të kufizuara, probleme shëndetësore, barriera që lidhen me sistemet e arsimit dhe trajnimit, dallime kulturore, barrierat sociale, barriera ekonomike, barriera që lidhen me diskriminimin, barrierat gjeografike etj.
2. Dorëzimi i dokumentave të aplikimit kryhet prej aplikantit dorazi, në zarf të mbyllur pranë Protokollit- Arkivës të UV-së gjatë fashës kohore sipas përcaktimeve të shpallura në thirrjen për aplikim.

Neni 24

Komisioni Ad-Hoc i vlerësimit të aplikimeve

1. Në përfundim të afatit të aplikimit të vendosur në thirrje, ngrihet prej Rektorit një komision ad-hoc, i cili do të bëjë vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar prej aplikantëve dhe do të rendisë kandidatët në bazë të skemës së pikëzimit si dhe kritereve të thirrjes.
2. SMJ u komunikon drejtuesve të departamenteve fushat e aplikimeve të mbërritura për të vazhduar me hapat e mëtejshëm për ngritjen e komisionit ad-hoc.
3. Në rastet kur thirrja i adresohet vetëm personelit akademik të UV-së që i përkasin një fushe studimi referuar në kodet ISCED të marrëveshjes ndërinstitucionale, Rektori ngre komisionin ad-hoc me përbërje si më poshtë:
 - a) 3 (tre) anëtarë, staf akademik me kohë të plotë, të njësisë bazë që mbulon këtë fushë studimi, të propozuar nga Drejtuesi i njësisë kryesore.
 - b) 1(një) anëtar nga SMJ.
 - c) 1(një) anëtar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

4. Në rastet kur thirrja i adresohet personelit akademik të UV-së që i përkasin dy a më tepër fushave të studimit referuar në kodet ISCED të marrëveshjes ndërinstitucionale, Rektori ngre komisionin ad-hoc me përbërje si më poshtë:
 - a) 3(tre) anëtarë, staf akademik me kohë të plotë, të njësive bazë që mbulojnë këto fusha studimi, të propozuar nga Drejtuesi i njësive kryesore. Në rast se fushat e studimit u përkasin disa njësive kryesore, propozimet bëhen nga Rektori.
 - b) 1(një) anëtar nga SMJ.
 - c) 1(një) anëtar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit.
5. Në rastet kur thirrja i adresohet personelit ndihmës akademik dhe administrativ të UV-së, Rektori ngre komisionin ad-hoc me përbërje si më poshtë:
 - a) 3(tre) anëtarë, staf jo-akademik me kohë të plotë, sipas sektorëve të varësisë.
 - b) 1(një) anëtar nga SMJ.
 - c) 1(një) anëtar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit.
6. Anëtarët e komisioni ad-hoc njoftohen prej protokollit të UV-së mbi urdhërin e Rektorit dhe ndërkohë kryetari i komisionit ad-hoc thërret mbledhjen e anëtarëve brenda 3 (tre) ditëve të punës për të përfunduar procesin e vlerësimit dhe renditjen e kandidatëve aplikues.
7. Komisioni ad-hoc vlerëson dhe rendit kandidatët duke aplikuar skemën e pikëzimit sipas shtojcës 12, si dhe përpilon vendimin sipas shtojcës 13.
8. Në rast të aplikimit të Koordinatorit të Marrëveshjes ai miratohet me prioritet.
9. Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, komisioni ad-hoc do t'u japi prioritet:
 - a) Personelit, i cili është me aftësi të kufizuara, probleme shëndetësore, barriera që lidhen me sistemet e arsimit dhe trajnimit, dallime kulturore, barrierat sociale, barriera ekonomike, barriera që lidhen me diskriminimin, barrierat gjeografike etj.
 - b) Personelit që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1 ICM.
 - c) Barazia gjinore (aty ku është e mundur, të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).
10. Komisioni ad-hoc i përcjell vendimin e protokolluar SMJ-së, për ta dërguar në postën elektronike (e-mail) tek i gjithë personeli aplikantë.
11. Proçesi i brendshëm i nominimit nuk garanton që mobiliteti do të kryhet. Nominimi duhet të konfirmohet nga institucioni pritës përmes një letre pranimi.

Neni 25

Komisioni Ad-Hoc i apelimit

1. Në rastin kur aplikantët kanë ankimuar vendimin ad-hoc, Rektori ngre një komision apelimi me përbërje si më poshtë :
 - 3 (tre) anëtarë, staf akademik me kohë të plotë, të njësive bazë që mbulon këtë fushë studimi, të propozuar nga Drejtuesi i njësive kryesore.
 - 1(një) anëtar nga SMJ.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- 1 (një) anëtar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit.
- 2. Personeli aplikues ka të drejtën e ankimit të vendimit të komisionit *ad-hoc* pranë Rektorit brenda 3 (tre) ditëve të punës nga marrja e njoftimit.
- 3. Në rastin kur aplikantët kanë ankimuar vendimin *ad-hoc*, Rektori ngre një komision apelimi.
- 4. Anëtarët e komisioni të apelimit njoftohen prej protokollit të UV-së mbi urdhërin e Rektorit dhe ndërkohë, kryetari i komisionit të apelimit pas marrjes së njoftimit thërret mbledhjen e anëtarëve brenda 3 (tre) ditëve të punës për të përfunduar procesin e shqyrtimit të ankesës.
- 5. Vendimi i komisionit të apelimit është përfundimtar dhe i pa ankimeshëm.
- 6. Kryetari i komisionit të apelimit i përcjell vendimin e protokolluar SMJ-së, që kjo e fundit ta dërgojë me postë elektronike (e-mail) tek ankimuesit.

Neni 26

Njoftimi i listës së personelit të nominuar

1. Në përfundim të afatit të ankimit, SMJ njofton institucionin partner, personelin e nominuar, eprorin më të afërt dhe koordinatorin e marrëveshjes mbi vendimin *ad-hoc* për personelin e UV-së.
2. SMJ i vendos në dispozicion institucionit partner kopje të vendimit *ad-hoc* ose çdo dokument tjetër sipas rastit.
3. Institucioni partner konfirmon pranimin e kandidatëve nëpërmjet e-mail apo formave të ngjashme.

Neni 27

Mbështetja e personelit të nominuar dhe marrëveshja e mobilitetit

1. SMJ mbështet personelin e UV-së me procedurat për përgatitjen për mobilitet duke i dhënë informacion dhe ndihmën e nevojshme sipas rastit për mënyrën e aplikimit, për institucionin partner, qytetin, akomodimin etj.
2. Përpara fillimit të mobilitetit, personeli i nominuar dakordëson planin e mobilitetit të detajuar me institucionin partner mbi të gjithë aktivitetet që do të ndërmerren gjatë periudhës së mobilitetit.
3. Personeli i UV-së, eprori më i afërt i tij dhe Rektori i UV-së nënshkruan me përfaqësuesit e institucionit partner një marrëveshje mobiliteti për mësimdhënie apo trajnim sipas rastit.

Neni 28

Njohja e periudhës së mobilitetit

Institucioni partner çertifikon pjesëmarrjen në mobilitet të personelit të UV-së përmes një dokumenti, që konfirmon datat e fillimit dhe përfundimit të mobilitetit dhe aktivitetin e kryer sipas marrëveshjes së mobilitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 29

Detyrimet e personelit të UV-së

1. Me qëllim rritjen e impaktit në nivel individual, njësie, institucioni dhe më gjerë, personeli i UV-së përfitues i bursës Erasmus+KA1 duhet të shpërndajë informacionin mbi eksperiencën e mobilitetit të tyre në forma të ndryshme diseminimi sipas rastit.
2. Çdo personel i UV-së është i detyruar të plotësojë pyetësorin "*Participant Report Form*" nga Komisioni Evropian, i cili përmban pyetje për mobilitetin dhe rezultatet e arritura përmes tij.
3. Çdo personel i UV-së duhet të raportojë nëpërmjet skedës informuese, të miratuar me vendim senati nr.22 datë 24.10.2024 për pjesëmarrjen aktivitetet Erasmus+KA1 ICM

KREU V

PROCEDURA PËR MOBILITETE STAFI HYRËS

Neni 30

Njoftimi prej universitetit partner

1. Procedura përzgjedhëse për personelin hyrës, që vijnë me mobilitet në UV kryhet nga institucioni partner.
2. Institucioni partner dërgon emrat e personelit të nominuar pranë SMJ-së me të gjithë informacionin shoqërues të detajuar.

Neni 31

Të drejtat e personelit hyrës në UV

Personeli hyrës në UV gëzon të drejtën të mbështetet me çdo informacion apo dokument që kërkohet për mbarëvajtjen e mobiliteti të tyre.

Neni 32

Mbështetja e personelit hyrës dhe marrëveshja e mobilitetit

1. SMJ kontakton me anë të e-mailit personelin hyrës të nominuar duke i lidhur me drejtuesin e njësisë bazë dhe koordinatoren e marrëveshjes, si dhe duke vendosur në dispozicion informacionin administrativ mbi hapat që duhen ndjekur para mbërritjes në UV.
2. Për personelin akademik hyrës, SMJ në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë përgatit një letër pranimi sipas shtojcës 14 si dhe mbështetet me procedurat e posacme për mobilitet duke i dhënë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për mënyrën e aplikimit të lejeqendrimit, akomodimin, lehtësira të tjera sipas kërkesave të parashtruara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

3. Për personelin ndihmës akademik dhe administrativ hyrës, SMJ në bashkëpunim me sektorët përkatës përgatisin një letër pranimi sipas shtojcave 15,16 si dhe mbështetet me procedurat e posacme për mobilitet duke i dhënë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për mënyrën e aplikimit të lejeqendrimit, akomodimin, lehtësira të tjera sipas kërkesave të parashtruara.
4. Drejtuesi i njësisë bazë dhe koodinatori i marrëveshjes, si dhe sektorët në UV mbështesin personelin hyrës me çdo çështje akademike deri në finalizimin e marrëveshjes së mobilitetit.
5. Palët e përfshira në mobilitet sipas rastit (personeli hyrës, drejtuesi i njësisë bazë, koordinatori marrëveshjes, sektorët përkatës dhe Rektori) nënshkruajnë marrëveshjen e mobilitetit.

Neni 33

Regjistrimi në UV

1. Personeli hyrës me ardhjen në UV paraqitet pranë SMJ-së për të kryer dhe marrë udhëzimet e nevojshme mbi procedurat administrative gjatë mobiliteti pranë UV-së.
2. SMJ regjistron personelin hyrës në bazën e saj të të dhënave.

Neni 34

Njohja e periudhës së mobilitetit

UV çertifikon pjesëmarrjen në mobilitet të personelit hyrës në UV përmes një dokumenti sipas shtojcave 17, 18 ku konfirmohen datat e fillimit dhe përfundimit të mobilitetit dhe aktivitetin e kryer sipas marrëveshjes së mobilitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Monitorimi i marrëveshjeve ndër-institucionale

1. SMJ është njësi përgjegjëse, e cila monitorohet prej Zyrës Kombëtare Erasmus+ në Shqipëri mbi zbatimin në mënyrë korrekte të mobiliteteve në kuadër të programit Erasmus+ KA1 si mëposhtë për:
 - a) Përputhjen me parimet e përcaktuara në Kartën Erasmus për Arsimin e Lartë (ECHE), të përfshira në marrëveshjet ndër-institucionale.
 - b) Plotësimin në mënyrë korrekte dhe nënshkrimin e të gjitha dokumenteve të detyrueshme duke përdorur shtojcat e përmendura në këtë rregullore.
 - c) Përdorimin e kritereve të drejta, transparente dhe të dokumentuara për përzgjedhjen e pjesëmarrësve të tyre;
 - d) Ofrimin e shërbimeve të parashikuara sipas programit Erasmus+ KA1 për gjitha kategoritë e studentëve dhe personelit të përfshirë në zbatimin e programit.
 - e) Njohjen e procesit të mobilitetit për gjitha kategoritë e studentëve dhe personelit të përfshirë në zbatimin e programit Erasmus+KA1.
 - f) Raportimin e problematikave të hasura gjatë implementimit të mobiliteteve për student dhe personel.
 - g) Azhornimin e bazës së të dhënave për të gjitha llojet e mobiliteteve të zhvilluara me informacionin përkatës etj.
2. Në çdo rast, duhet të mbahet në vëmendje Guida e Programit Erasmus + dhe Udhëzuesi për *International Credit Mobility* për të konsultuar hapat që ndiqen dhe reflektuar çdo ndryshim të mundshëm që mund të paraqitet në guidën e përvitshme të programit.
3. Me qëllim rritjen e impaktit në nivel individual, njësie, institucioni dhe më gjerë, studentët dhe personeli duhet të shpërndajnë informacionin mbi eksperiencën e mobilitetit të tyre në forma të ndryshme diseminimi sipas rastit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 36
Shtojcat e dokumenteve

Pjesë e kësaj rregulloreje janë shtojcat, që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

- SHTOJCA 1: MODEL I MARRËVESHJES NDËRINSTITUCIONALE
- SHTOJCA 2: MODEL I THIRRJES PËR APLIKIM PËR MOBILITET STUDENT DALËS
- SHTOJCA 3: MODEL I FORMULARIT TË APLIKIMI PËR STUDENT DALËS
- SHTOJCA 4: MODEL I SKEMËS SË PIKËZIMIT PËR STUDENTËT DALËS
- SHTOJCA 5: MODEL I VENDIMIT AD-HOC PËR STUDENTËT DALËS
- SHTOJCA 6: MODEL I MARRËVESHJES LËNDORE
- SHTOJCA 7: MODEL I DOKUMENTIT TË NJOHJES DHE NJEHSIMIT TË PERIUDHËS SË MOBILITETIT PËR STUDENTËT DALËS
- SHTOJCA 8: MODEL I LETRËS SË PRANIMI PËR STUDENTË HYRËS
- SHTOJCA 9: MODEL I TRANSKRIPTIT PËR STUDENTË HYRËS
- SHTOJCA 10: MODEL I THIRRJES PËR APLIKIM PËR MOBILITET PERSONELI DALËS
- SHTOJCA 11: FORMULAR APLIKIMI PERSONEL DALËS
- SHTOJCA 12: MODEL I SKEMËS SË PIKËZIMIT PËR PERSONEL DALËS
- SHTOJCA 13: MODEL I VENDIMIT AD-HOC PËR PERSONELIN DALËS
- SHTOJCA 14 : MODEL I MARRËVESHJES SË MOBILITETIT TË STAFIT DALËS
- SHTOJCA 15: MODEL: LETËR PRANIMI PËR PERSONEL AKADEMIK HYRËS
- SHTOJCA 16: MODEL LETËR PRANIMI PËR PERSONEL ADMINISTRATIV HYRËS
- SHTOJCA 17: ÇERTIFIKATË PJESËMARRJE PËR STAF AKADEMIK HYRËS
- SHTOJCA 18: ÇERTIFIKATË PJESËMARRJE PËR STAF ADMINISTRATIV HYRËS

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

SHTOJCA 1: MODELI I MARRËVESHJES NDËRINSTITUCIONALE

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/document/editable-bilateral-multilateral-agreement-international-mobility>

EUROPEAN UNION		Erasmus+ Enabling lives, opening minds (2021-2027)																																																						
I Erasmus+ Programme Inter-institutional agreement Key Action 1 Mobility of higher education students and staff between EU Member States and third countries associated to the Programme and third countries not associated to the Programme Information in highlight are instructions and should be deleted before signing the agreement																																																								
The institutions named below agree to cooperate for the exchange of students and/or staff in the context of the Erasmus+ programme. This agreement is valid for the Erasmus+ call years 2021-2027 in: - KA131 Higher education mobility supported by internal policy funds - KA171 Higher education mobility supported by external policy funds The institutions commit to sound and transparent management of funds allocated to them through Erasmus+ and to respect the quality requirements of the Programme, outlined in the Erasmus Charter for Higher Education, and in this agreement. The institutions agree on exchanging their mobility-related data according to the principles of data, and in line with the technical standards of the European Student Card Initiative, when this becomes available for international mobility involving third countries not associated to the Programme. Sending institutions located in EU/EEA countries have to ensure compliance with the provisions of art. 46 GDPR for all participants' personal data exchanged in the context of their mobility with institutions from non-EU/EEA countries without an adequate decision, on the condition that enforceable data subject rights and effective legal remedies for data subjects are available in the respective third country. The participants should be informed in a transparent manner about the level of protection of their personal data, if this is different from the one where the sending institution is located. * Inter-institutional agreements can be bilateral or multilateral in the case of mobility consortia - Bilateral agreements are for cooperation between one higher education institution located in an EU Member State or third country associated to the Programme and another institution located in a third country not associated to the Programme - Multilateral agreements are for cooperation between a mobility consortium of higher education institutions located in one single EU Member State or third country associated to the Programme and another institution located in a third country not associated to the Programme * https://ec.europa.eu/erasmus-plus/en/erasmus-plus-agreements-between-higher-education-institutions * https://ec.europa.eu/erasmus-plus/en/erasmus-plus-agreements-between-higher-education-institutions * https://ec.europa.eu/erasmus-plus/en/erasmus-plus-agreements-between-higher-education-institutions																																																								
1. Information about the higher education institutions <table border="1"><thead><tr><th>Name of the institution (and department where relevant)</th><th>Erasmus code or city*</th><th>Contact details* (email, phone)</th><th>Websites</th></tr></thead><tbody><tr><td></td><td></td><td>General: Faculty/faculties: Course catalogue:</td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td>General: Faculty/faculties: Course catalogue:</td><td></td></tr><tr><td>[...]</td><td></td><td></td><td></td></tr></tbody></table> * Higher education institutions (HEIs) from EU Member States or third countries associated to the Programme should indicate their Erasmus code (HEIs from third countries not associated to the Programme should mention the city where they are located). * Contact details to reach the senior officer in charge of this agreement and of its possible updates.				Name of the institution (and department where relevant)	Erasmus code or city*	Contact details* (email, phone)	Websites			General: Faculty/faculties: Course catalogue:				General: Faculty/faculties: Course catalogue:		[...]																																								
